

2049  
17.12.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 808, datë 11.12.2019

P Ë R

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.112, DATË 23.2.2018,**  
**TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN**  
**E KRITEREVE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"**  
**DHE TË STANDARDEVE SHTETËRORE PËR FITIMIN E TITUJVE**  
**AKADEMIKË "PROFESOR I ASOCIUAR" DHE "PROFESOR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 60, pika 3, e 79, pika 7, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Kudo në tekstin e vendimit, emërtimi "*Thomson Reuters*", zëvendësohet me emërtimin "*Journal Citation Reports*";

b) Në pikën 3, të kreut I, bëhen këto ndryshime:

i. Shkronjat "a" dhe "b", ndryshohen, si më poshtë vijon:

"a) jo më shumë se 3 (tre), në rastin e personelit akademik që mban titullin "Profesor";

b) jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin "Profesor i Asociuar";";

ii. Shkronja "c" shfuqizohet.

c) Shkronja "b", e pikës 6, të kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në *Journal Citation Reports* ose *Scopus*, ku është, së paku, autor i dytë.”.

ç) Pika 8, e kreut V, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I ARSIMIT,  
SPORTIT DHE RINISË

**Në mungesë dhe me porosi**

BESA SHAHINI

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

NR.PROT. 5571/1  
DATË 16.12. 2019

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
AGJENCISË KOMBËTARE PËR KËRKIMIN  
SHKENCOR DHE INOVACIONIN  
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll Agaçi', is written over a circular official stamp. The stamp contains text in Albanian, including 'REPUBLIKA E SHQIPËRIE' and 'MINISTRI E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË'.